



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 21.03.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 19.03.2024, të parashtruar nga Operatori ekonomik N.T.P. "LULISHTJA BUÇAJ", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me fidane dhe drunjë dekorativ-Kontratë dy vjeçare", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-740-1-1-1, Nr. i brendshëm-632-24-003-111, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorit ekonomik: N.T.P. "LULISHTJA BUÇAJ", e dt.19.03.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Furnizim me fidane dhe drunjë dekorativ-Kontratë dy vjeçare", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-740-1-1-1, Nr. i brendshëm-632-24-003-111, kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë të AK -së, të datës 06.02.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË** e publikuara me datë: 06.02.2024;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik N.T.P. "LULISHTJA BUÇAJ", me dt.19.03.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me fidane dhe drunjë dekorativ-Kontratë dy vjeçare", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-740-1-1-1, Nr. i brendshëm-632-24-003-111.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 21.03.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Për të gjitha pikat që tuaja ankimore, Autoriteti Kontraktues, ka dhënë shpjegime të mjaftueshme ku janë të përfshira gjitha specifikimet teknike: mosha e fidanit, perimetri i trungut, lartësia e fidanit, vazot shprehur në litra etj.

Bazuar në kërkesën e tuaj për rishqyrtim të dt.04.03.2024, Autoriteti Kontraktues me dt.06.03.2024 e ka bërë përshkrimin e çmimit(paramases) komplet dhe ka korrigjuar paramasën dhe dosjen e tenderit, prandaj pretendimi juaj nuk qëndron.

Askund me asnjë standard nuk është e caktuar që madhësia e vazos të jetë në proporcion me madhësinë e fidanit. Këto fidane do të qëndrojnë në vazo për një kohë më të gjatë dhe nuk do të mbillen në tokë., prandaj Autoriteti kontraktues kërkon që vazot të jenë minimum 130 litra në mënyrë që fidanët të zhvillohen normalisht.

Pretendimi juaj për Columnaris dhe Shemshir, nuk qëndron, sepse në paramasë është e caktuar gjatësia e fidanit dhe është përmirësuar paramasa. Po ashtu, është normale që fidanët halorë të vijnë me vazo të zakonshme të plastikës d.m.th. vazot duhet të jenë të plastikës.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit